



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Tipologji teksti 3

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione / 40 seminare

Viti / Semestri : Viti II/semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të ketë të qartë tashme format e ligjërimit dhe si rrjedhojë edhe llojet e teksteve. Të ketë të qarta kriteret dhe karakteristikat e ligjërimit dhe pjeseve me natyrë tregimtare dhe përshkruese. Të jetë i aftë të gjejë dhe përzgjedhe informacione teorike si dhe të përzgjedhë vetë dokumente dhe tekste në funksion të tematikës që po studiohet dhe analizohet në orën e mësimi. Tipologjia e tekstit është e organizuar rreth aktiviteteve që synojnë në një trajtim teorik dhe praktik të një teksti autentik si dhe të gjitha llojet e tjera tekstesh, në elementet e saj përbërëse.

Objektivat konkrete të mësimi janë:

- 1) Të mësohet për të dalluar llojet e teksteve ose formave të ligjerates (shpjeguese, informuese dhe argumentuese);
- 2) Të mësohet për të dalluar regjistrat gjuhësore;
- 3) Zhvillimin e të menduarit kritik;
- 4) Redaktimi i një analize me shkrim.

Objektivat specifike lëndore:

1. Pjesa e tretë e këtij kursi përqendrohet në studimin dhe analizimin e teksteve me karakter kryesisht shpjegues/informues dhe argumentues.
2. Objektivat didaktike të kërkuara janë: studenti të aftësohet të dallojë llojet e ndryshme të teksteve ose format e ligjërimit; të dallojë regjistrat e ndryshme të gjuhës; të hartojë dhe analizojë.
3. Në fund të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të: - të dallojnë karakteristikat e realizimit të teksteve letrare dhe joletrare (e shtypit), ti klasifikojë ato në grupe sipas tipologjisë së tyre : përshkrues, tregues, shpjegues, argumentues; - Për të kuptuar përmbajtjen (eksplicite dhe implicite) të një teksti dhe identifikimin strukturor të saj. Studentët inkurajohen për të zhvilluar njohuritë e tyre të përgjithshme si dhe të zhvillojnë të menduarit kritik.